

Numri i lëndës: 2024:030942

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05416673

PPP.nr.01/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA E GJYKATËS NË V., Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Alush Sinani lidhur me çështjen përmbarimore të kreditorit M.A.nga fshati Komuna e V., i përfaqësuar nga X.H.avokat në V., duke vendosur sipas prapësimit të debitorit Byroja Kosovare e Sigurimit “BSK” me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga KS “Eurosig”, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 2,154.00 €, të parashtruar nga debitori me datën 23.01.2024, kundër Urdhërit Përmbarimor P.nr; 85/2024, te dates 09.01.2024, i lëshuar nga përmbaruesi privat A.X.nga V., sipas dokumentit të besueshëm, gjykata jashtë seancës me datën 05.03.2024 xjerr këtë;

A K T V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit Byroja Kosovare e Sigurimit “BSK” me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga KS “Eurosig”, i paraqitur kundër Urdhërit Përmbarimor P.nr; 85/2024, te dates 09.01.2024, i lëshuar nga përmbaruesi privat A.X.nga V.a, sa i përket shumës së borxhit prej 2,154.00 euro dhe **SHFUQIZOHET** Përmbarimor P.nr; 85/2024, te dates 09.01.2024, për shumën e borxhit prej 2,154.00 euro.

II. REFUZHET prapësimi i debitorit, i ushtruar kundër Urdhërit Përmbarimor P.nr; 85/2024, te dates 09.01.2024, i lëshuar nga përmbaruesi privat A.X.nga V.a, sa i përket shpenzimeve të procedurës së përmbarimit edhe atë shumës së mjeteve prej prej 156 euro, në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim si dhe shumës së mjeteve prej 156 euro, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësimin e debitorit.

III. MBETET NË FUQI urdhëri për përmbarim sa i përket shpenzimeve të procedurës së përmbarimit; shumës së mjeteve prej 156 euro në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim dhe shumës së mjeteve prej 156 euro në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësimin e debitorit dhe shpenzimet tjera te procedurës përmbarimore.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.85/2024, të datës 09.01.2024, përmbaruesi privat A.X.nga V.a, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit X.H.avikat, kundër debitorit Byroja Kosovare e Sigurimit “BSK” me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga KS “Eurosig”, për pagesën e borgjit në shumë të përgjithshme prej 2,154.00 euro, në bazë të Pajtitimit gjyqësor C.nr.64/2019, të datës 05.12.2023, i lëshuar nga Gjkata Themelore në Gjilan, Dega në V. ose ndalimin e mjeteve në para nga llogaria e debitorit dhe transferimin në llogari të kreditorit.

Debitori, pas pranimit të Urdhërit për Përmbarim, në afat ligjor më dt.19.01.2024, ka ushtruar prapësim duke theksuar se pala debitore e ka kryer obligimin, andaj duke u bazuar në nenin 70 dhe 71 të Ligjit për procedurën përmbarimore dhe provat e bashkangjitura prapsimit gjykat të bije aktvendim dhe të aprovoj prapsimin e debitorit “BSK” me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga KS “Eurosig” sepse ky urdhër përmbarimor nuk mundet të ekzekutohet, pasi që është kryer

obligimi, ka prpozuar që kreditori të ia paguaj shpenzimet e procedurës përbarimore pa i specifikuar ato.

Kreditori në afatin ligjor me datën 25.01.2024, ka ushtruar përgjegje në prapsim, lidhur me pretendimin e debitorit sipas të cilit e ka përmbushur detyrimin, duke e paguar borgjin prej 2.154.00 euro, i caktuar sipas Pajtimit gjyqësor me numër Cnr 64/2019, i datës 05.12.2023, kreditori në përgjigjeje të parapsimit ka theksuar se sipas Pajtimit gjyqësor, debitori ka pas për obligim që ta përmbush obligimin në afat prej 30 ditës, pra data e fundit ka qenë 05.01.2024, gjë të cilën debitori nuk e ka përmbushur, i njejtë ka prezentuar si provë fletë transerin e lëshuar nga Banka Ekonomike e datës 11.01.2024, me të cilën deshmohet se transferi i shumës prej 2,154.00 euro është basrtur në llogarin e përfaqësuesit të kreditorit me datë 12.01.2024, e megjese debitori nuk e ka përmbushur obligimin për pagesen e borgjit sipas kushteve të ërapara me pajtim gjyqësor, por borgjin e ka paguar me datë 12.01.2024, ndersa procedurën përbarimore e ka filluar te përbarusi privat A.X.me datë 09.01.2024, prandaj në fund ka theksuar se tani i kërkojn vetem shpenzimet e procedurës përbarimore.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përbarim dhe pretendimet në prapësim të autorizuarit të debitorit, përgjigjejen me shkrim të kreditorit në në prapësimin e debitorit dhe gjeti se prapësimi është pjesërisht i bazuar.

Gjykata vlerëson se urdhri mbi lejimin e përbarimit P.nr.85/2024, i datës 09.01.2024, i lëshuar nga përbaruesi privat A.X., është pjesërisht i ligjshëm dhe i rregullt, përkatësisht është i ligjshëm sa i përket shpenzimeve të procedurës së përbarimit edhe atë për shumën e mjeteve prej 156 euro, në emër të përpilimit të propozimit për përbarim si dhe shumës së mjeteve prej 156 euro, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësimin e debitorit, ndërsa nuk është i ligjshëm urdhri për përbarim sa i përket shumës së borxhit prej 2,154.00 euro.

Sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se: gjendja faktike është krejtësisht tjetër nga ajo e prezantuar dhe në bazë të provave dhe fakteve që i janë bashkangjitur këtij prapësimi, vërtetohet se pretendimet e kreditorit janë plotësisht të pabazuara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, propozimi nuk i plotëson kushtet ligjore, dhe se përbaruesi privat pa analizuar fare shkresat e lëndës, në kundërshtim me dispozitat e LPP-së e ka lejuar përbarimin, Gjykata këto pretendime i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme sepse me rastin e vendosjes lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin për përbarim, nuk ka kompetencë të bëjë vërtetim ndryshe të gjendjes faktike nga ajo e cila është vërtetuar me nxjerrjen e Pajtimit Gjyqësor C.nr.64/2019, të datës 05.12.2024, nga Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në V., dhe se gjykata në këtë rast ka për detyrë vetëm ta bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së nxjerrjes së urdhrin për përbarim P.nr. 85/2024, të datës 09.01.2024, kundër të cilit është ushtruar prapësim nga debitori, ku siç vërtetohet nga shkresat e lëndës, përbaruesi privat A.X., urdhrin për përbarim të cekur më lart e ka nxjerrë në pajtim me nenin 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së, në bazë të Pajtimit gjyqësor C.nr.64/2019, të datës 05.12.2023, i cili i plotëson të gjitha kushtet ligjore për tu cilësuar si dokument përbarimor sepse i njëjti siq shihet është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, respektivisht është i pajisur me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri, kusht ky i kërkuar në nenin 36, par 1, të LPP-së. Po ashtu gjykata konstaton se kreditori propozimin për përbarim e ka ushtruar në pajtim të plotë me nenin 38, par 1, të LPP-së, sepse propozimi i kreditorit e përmban kërkesën për përbarim,

dokumentin përmbartimor në origjinal, të dhënat e kreditorit dhe të debitorit, adresën e vendbanimit dhe të selisë së palëve, kredinë që kërkohet të realizohet si dhe mjetin përmes të cilit duhet kryer përmbartimi.

Kurse sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se debitori më datë 12.01.2024, brenda afatit vullnetar e ka paguar dhe e ka përmbushur në tërësi obligimin e vet ndaj kreditorit, Gjykata këtë pretendim e konsideron pjesërisht të bazuar sepse nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës përkatësisht nga prova e dorëzuar nga debitori, siq është raporti bankar i lëshuar nga Banka Ekonomike, i datës 12.01.2024, vërtetohet se debitori më datë 12.01.2024, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit ka transferuar shumën e borxhit kryesor të kërkuar nga kreditori mirëpo nuk i ka paguar edhe shpenzimet e procedurës së përmbartimit siq janë cekur më lart në shkresat e lëndës, gjegjësisht nga propozimi për përmbartim i ushtruar nga i autorizuari i kreditorit vërtetohet se i autorizuari i kreditorit propozimin për përmbartim në emër të kreditorit e ka ushtruar me datë 09.01.2024, ndërsa debitori pagesën e borxhit kryesor e ka bërë më datë 12.01.2024, pra debitori nuk ka vepruar në bazë të Pajtitimit Gjyqësor C.nr.64/2019, të datës 05.12.2024, të Gjykates Themelore në Gjilan, Dega në V., sepse debitori pagesën e borxhit kryesor e ka bërë 7 (shtatë) ditë pasi ka kaluar afati i cekur në Pajtimin Gjyqësor me të cilin ishte caktuar afati prej 30 (tridhjetë) ditë nga dita e lidhjes së Pajtitimit gjyqësor.

Për më tepër në nenin 13, par 4, të LPP-së, është përcaktuar shprehimisht: “Debitori ka për detyrë që kreditorit t’ia paguaj shpenzimet procedurale dhe të gjitha shpenzimet tjera të shkaktuara gjatë procedurës së përmbartimit”.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS V.
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
2024:030942, 05.03.2024
PPP.nr.01/2024,

Gjyqtari,
Alush Sinani

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK : Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes Gjykatës Themelore në